



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Datë: 17.10.2023

Në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr. 03/L-40 mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut, nenit 5, 12, 14 paragrafi (1) pika (1.1), 1.4) dhe (1.8) dhe neni 15 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, me nr.prot. 02-180-9082 të datës 06.11.2018, Kryetari i Komunës më datë 17.10.2023 shpall:

KONKURS

PËR NDARJEN E BURSIVE PËR NXËNËS DHE STUDENTË TË KOMUNËS SË JUNIKUT

- I. Komuna e Junikut, ndanë gjithsej 50 bursa për student për vitin akademik 2023-2024, Dhe shpërblime për nxënës të nivelit arsimor 1,2 dhe 3 që kanë arritur rezultate të para në nivel kombëtar dhe ndërkombëtarë për vitin 2022,
 1. Lartësia e bursës për studentë të regjistruar në Universitetet Publike apo private në Republikën e Kosovës është 400.00 €, për vitin akademik, ndërsa shpërblimi për nxënës të niveleve të lartë është 100.00€
- II. Kushtet për konkurrim për bursë komunale:
 1. Të jetë banor i Komunës së Junikut;
 2. Të jetë student i rregullt dhe të ketë të regjistruar vitin akademik 2023-2024, në ndonjërin nga Universitetet Publike apo Private të Republikës së Kosovës;
 3. Të jetë student i nivelit 5-të (Post-Sekondar), Bachelor, Sistem katërvjeçar apo Master;
- III. Kriteret për përzgjedhjen e përfituesve të bursave komunale:
 1. Përzgjedhja e përfituesve të bursave komunale bëhet në bazë të numrit më të madh të pikëve totale që merr një kandidat, bazuar në kriteret e specifikuar më poshtë.
 2. Nëse një kandidat plotëson më shumë se një nga kriteret/kategoritë e mëposhtme, atëherë mbledhet totali i pikëve të fituara nga secila kategori (përveç pikëve për notë mesatare, të

cilat i fiton varësisht prej notës mesatare që ka kandidati). Nëse kandidatët mbasin me pikë të barabarta, atëherë vendoset duke i dhënë përparësi kategorive të luftës, gjinisë femërore dhe studentëve që udhëtojnë në distancë më të madhe.

3. Aplikuesi nuk mund të jetë përfitues i bursës nëse brenda vitit të njëjtë fiskal ka qenë përfitues i një burse të ndarë nga pushteti qendror ose ndonjë donatorë tjetër për fushën e njëjtë.

Nr	Kriteri/Kategoria	Pikët
1.	Nota mesatare 9-10 Nota mesatare 8-9 Nota mesatare 7-8	40-50 30-40 20-30
2.	Studentët që kanë të regjistruar vitin e parë që kanë notën mesatare 3-5 nga shkolla e mesme.	30-50
3.	Studentët me nevoja të veçanta.	20
4.	Studentët me asistencë sociale.	20
5.	Studentët – fëmijët bonjak (pa asnjërin prind).	20
6.	Studentët-fëmijët që kanë mbetur pa njërin prind si pasojë e luftës (fëmijët e dëshmorëve dhe/ose viktimave civile).	20
7.	Studentët-fëmijët e invalidëve të UÇK-së.	10
8.	Studentët-fëmijët e veteranëve të UÇK-së.	05
9.	Studentët që studiojnë më shumë se një drejtim studimi - mund të jetë edhe në nivel tjetër të studimeve (Master ose Doktoraturë).	10
10	Studentët që kanë edhe ndonjë anëtar tjetër të familjes së ngushtë në studime (motër, vëlla, prind, fëmijë). Anëtar tjetër mund të jetë edhe në nivel tjetër të studimeve (Master ose Doktoraturë).	10
11	Studentët në Fakultetin e Mjekësisë.	20
12	Studentët në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore.	20
13	Student në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës	20
14	Student në fakultetin e Inxhinieris Mekanike	20
15	Student në Fakultetin të Bujqësisë dhe Veterinaris.	20
16	Student në fakultetin I Elektrike dhe Kompjuterike	20
17	Student në Fakultetin I Arteve	20
18	Student në Fakultetin Ekonomik	20
19	Student në Fakultetin I Edukimit Fizik dhe Sportit	20
20	Student në Fakultetin I Edukimit	20
21	Student në Fakultetin e Menagjimit në Turizem, Hotelieri dhe Mjedis	20
22	Student i regjistruar në Univeristetit Publikë	20

- IV. Statuset e të gjitha kategorive të përfshira në tabelën e mësipërme duhet të dëshmohen me dokumente e vlefshme të lëshuara nga institucionet relevante, siç përshkruhet më poshtë.

- V. Aplikacioni duhet të ketë këto dokumente të përgjithshme:

- Formularin e aplikimit të plotësuar (merret në zyrën pritëse në katin e parë) ose shkarkohet nga faqja e Komunës <https://kk.rks-gov.net/junik/>,
- Dokumentin personal (letërnjoftimin ose pasaportën),
- Ekstraktin e lindjes,
- Kartelen Identifikuese të studentit,
- Vërtetimin nga Universiteti Publik/Privat (fakulteti apo departamenti përkatës) se kandidati është student i/e rregullt dhe ka regjistruar vitin akademik 2023-2024, duke specifikuar fakultetin/drejtimin e studimeve dhe që kandidati nuk ka përsëritur (humbur) ndonjë vit akademik.
- Certifikatën e notave të studimeve (Originale),
- Certifikatën e notave të shkollës së mesme (Originale) për ata që kanë të regjistruar vitin e parë akademik.

Studentët e kategorive të shënuara më lartë duhet të dorëzojnë këto dokumente të veçanta:

- Studentët me nevoja të veçanta, vërtetimin nga institucioni përkatës,
- Studentët me asistencë sociale, vendimin nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe certifikatën familjare,
- Studentët bonjak, certifikatat e vdekjes së prindërve,
- Studentët – fëmijët e Dëshmorëve/viktimave civile, vendimin se është përfutës i pensionit nga Ministria e Financave, Punës dhe transfereve dhe certifikatën familjare,
- Studentët – fëmijët e Invalidëve të luftës, vendimin se është përfutës i pensionit nga Ministria e Financave, Punës dhe transfereve dhe certifikatën familjare,
- Studentët – fëmijët e Veteranëve të luftës vendimin se është përfutës i pensionit nga Ministria e Financave, Punës dhe transfereve dhe certifikatën familjare,
- Studentët që studiojnë më shumë se një drejtim studimi, dëshmi nga Fakulteti për drejtimin tjetër përveç atij që aplikon për bursë,
- Studentët që janë dy apo më shumë nga familja e ngushtë, dëshmi nga Fakulteti për statusin e studentit të anëtarit tjetër të familjes dhe certifikatën familjare.

Nxënësit e lartë cekur që kanë arritur rezultate të para në nivel kombëtar dhe ndërkombëtarë për vitin 2022, duhet të dorëzojnë këto dokumente të veçanta:

- Dëshmi nga institucionet përkatëse (Certifikata apo mirënjohje).

Sqarime shtesë

Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuara dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente përkatëse.

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi është i hapur prej datës 17.10.2023 deri më 31.10. 2023 në ora 16:00. Aplikacionet dorëzohen në zarf të mbyllur, në zyrën pritëse në Komunën e Junikut, apo të skenuara (aplikacioni duhet të jetë i nënshkruar) në email adresën zeqe.hebibi@rks-gov.net lindita.b.shehu@rks-gov.net Përfituesit e bursave do të informohen pas përzgjedhjes finale dhe rezultatet do të publikohen në web faqe të Komunës së Junikut.

Kryetari i Komunës
z. Ruzhdi Shehu

The image shows a circular official stamp of the Municipality of Junik. The text around the perimeter of the stamp reads "KOMUNA E JUNIKUT" at the top and "JUNIK" at the bottom. In the center of the stamp, there is a handwritten signature in blue ink.